



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**AC-I-22-0664-A0001**

**Në çështjen juridike të:**

**S B** nga, Prizren, i përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

**Paditësi/ankuesi**

**Kundër:**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)**, Rr. "Driton Hoxha" nr. 55, Lakrishte- Prishtinë.

**E paditura**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditesit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-7752, të datës 21 nëntor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditësit e datës 09 dhjetor 2022, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së, C-IV.-14-7752, të datës 21 nëntor 2022, konsiderohet e tërherqur.**
- 2. Asnjërsa palë nuk ka të drejtë në rimbursimin e shpenzimeve procedurale.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 18 prill 2014, paditësi parashtroi padi/ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likudimit të NSH NIN "Ramiz Sadiku"-Prizren, e administruar nga AKP, (AL i AKP-së)-PRZ 017-0004/0231, të datës 10 mars 2014. Me këtë vendim ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën nga 01 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, në shumë prej 1.013.00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (LPB), pasi që parashtruesi nuk ka dëshmuar që kjo

kërkesë të jetë parashtruar brenda 3 vitesh nga dita kur pretendohet të ketë lindur detyrimi i NSH-së ndaj paditësit.

Paditësi pretendon se kërkesa e tij është e drejtë dhe e bazuar pasi që NSH ka mbetur borxh për pagat e pa paguara, pasi që NSH është privatizuar më 23 mars 2006, dhe se në kohën e privatizimit ka qenë punëtor i ndërmarrjes, ku me rastin e privatizimit i është nderprerë kontrata e punës. Paditësi pretendon se në kohën e ndërprejes së marrëdhënies së punës ka qenë në aplikim Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 dhe 2005/48, pastaj me vonë është aprovuar edhe Ligji i Punës. Paditësi ka theksuar se atij dhe punëtorëve të tjerë në menyrë masive u është nderprerë marrëdhënia e punës dhe se kanë të drejtë në paga të pa paguara nga pala kundërshtare. E paditura i'a ka mohuar këtë të drejtë përmes refuzimit të kërkesës legjitime, me pretendimin se kërkesa është parashkruar.

Sipas paditësit vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së nuk është i arsyetuar në masë të mjaftueshme dhe se kërkesa e tij nuk është parashkruar siç pretendohet me vendimin e kundërshtuar. Ligji i Punës së Bashkuar nuk është në fuqi që nga viti 1989, ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet, ky ligj është shfuqizuar. Paditësi konsideron se se edhe nëse ky ligj të mos jetë shfuqizuar, prapë se prapë nuk kemi parashkrim, ngase shkaktari kryesor i mospagesës së pagave është Autoriteti i Likudimit.

Më 09 shkurt 2022, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura theksoi se me vendimin e kundërshtuar është vlersuar saktë gjendja faktike dhe është zbatuar në mënyrë të plotë e drejta materiale dhe është sjellë një vendim i drejtë dhe i bazuar dhe sit ë tillë e mbështet këtë vendim.

Më 21 nëntor 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykimin C-IV-14-7752 me të cilin e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar në ligj dhe e kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të AL të AKP-së si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Sipas arsyesimit të dhënë, paditësi pretendon në paga të pa paguara që i referohen viteve 1999-2005 dhe nuk ka prezantuar prova që dëshmon se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë organi kompetent në lidhje me borxhin e pretenduar. Kërkesën pranë AL të AKP-së e ka parashtruar më 01 gusht 2006, si kërkesë kolektive e dorëzuar nga kërkuesi A R si përfaqesues i grupit të punëtorve pa pasur autorizim të vlefshëm Autoritetit të Likudimit ka bërë kërkesë për dorëzimin e autorizimit, më 18 mars 2013, mirëpo autorizimi nuk është dorëzuar tek AL i AKP-së. Shkalla e parë ka konstatuar se në kuptim të nenit 376 paragrafi 1 të LMD-së, gjykata ka ardhë në përfundim se

kërkesa e pretenduar e parashtruesit për kompensim të pagave për periudhën nga data 01 korrik 1999, e deri më datën 19 dhjetor 2005, është parashkruar.

Më 09 dhjetor 2022, paditësi/ankuesi kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi duke propozuar që të aprovohet ankesa dhe të nxirret aktgjykim i ri me të cilin ankesa do të konsiderohet e pranueshme dhe të vazhdohet me procedimin e çështjes, ose ky aktgjykim të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim në shkallë të parë, duke e detyruar të paditurën që në emër të pagesës së pagave të pa paguara t'i paguajë paditësit/ankuesit shumën e borxhit kryesor prej 1.013.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës.

Ankuesi paraqet të njëjtat arsye dhe argumente se pse duhet të pranohet kërkesa e tij, që tashmë i ka parashtruar para Shkallës së parë., por në këtë fazë të procedurës ai dorëzon disa prova si: Listat e Pagave të hartuara nga kontabiliteti i N.SH në Prizren, të nënshkruara nga personat e autorizuar për periudhën korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, ku shihet se paditësi është i radhitur në numrin 231, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe librezën e punës.

Më 13 dhjetor 2022, Zyrtarja për financa e DHPGJSK-së ka nxjerrë vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore për ankesë në shumë prej 20 euro, brenda 15 ditësh. Me anë të këtij njoftimi, ankuesi është paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), nenit 6.4,6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit administrative 01/2017 për unifikimin e tarifave të gjykatës, do të konsiderohet e tërhequr. Ankuesi po ashtu është njoftuar se mund të parashtron kërkesën për lirim nga taksat gjyqësore në rast të mungesës së mjeteve financiare.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Shkalla e parë e kishte refuzuar ankesën e paditësit të parashtruar kundër vendimit të AL të AKP-së, me arsyetimin se kërkesa është e parashkruar.

Ankuesi kishte parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së me pretendimin se kërkesa nuk është parashkruar.

Zyra e regjistrimit të DHPGJSK-së kishte kërkuar nga ankuesi që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore në emër të ankesës para Kolegjit të Apelit, me vrejten se nëse nuk paguhet taksa apo nëse nuk bënë kërkesë për lirim nga kjo pagesë, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Sipas nenit 253.4 të ligjit të Procedurës kontestimore (LPK): "Padiësi ka pë detyrë që padiësi t'ia bashkangjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar".

Më tutje, neni 253.5 thotë që: "Në qoftë se padiësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, dhe nuk ekzistojnë kondiktat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr".

Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017(UA) të këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJL), përcaktimi i taksës gjyqësore për t'u paguar në kohën kur është paraqitur/paarshtuar parashtresa, është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e parashtresës.

Neni 2.4 i UA-së e përcakton se shprehja "Parashtresë", do të thotë padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, propozim për ekzekutim.

Udhëzimi i KGJK-së nr.01/2017 i aplikueshëm që nga data 15/03/2017 për unifikimin e Taksave Gjyqësore të DHPGJSK-së përcakton se ankuesi duhet të paguajë shumën fikse për parshtrimin e ankesës.

Pasi që ankuesi nuk e ka paguar taksën gjyqësore siq është kërkuar nga ai me njoftimin (vëretje) e datës 13 dhjetor 2022, që ishte pranuar nga përfaqesuesi padiësit/ankuesit më 20 dhjetor 2022, dhe nuk e ka paguar taksën gjyqësore si dhe nuk ka paraqitur kërkesë për lirimin nga taksa gjyqësore, Kolegji i Apelit konsideron se ankesa është tërhequr.

Sipas nenit 11 të ligjit për DHPGJS-në, pala e pasuksesshme duhet t'i paguajë shpenzimet procedural, përfshirë taksat gjyqësore të pales tjetër. Ankuesi në këtë çështje është palë e pasuksesshme, prandaj shpenzimet gjyqësore janë barrë e tij.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendosur nga Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së më 14 dhjetor 2023.

**Mr.Sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues** \_\_\_\_\_